## AKTI I THEMELIMIT
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ATLLAS "SH.P.K.

Ne Gjirokaster sot me daten IO.II.1997 une ortaku i vetem Vladimir Basha i biri i Maliqit i Dl. 1969 banues ne Kordhoc, Gjirokaster, vend se qe te themeloje shoqerine me pergjegjesine te kufizuar sipas ligjit Nr. 7638 date I9.II.I992 "Per shoqerite tregetare" dhe ligjit Nr. 7667 date 28.I.I993 "Per regjistrin tregetar..." duke redaktuar kete Akt themelimi me permbajtje si me poshte:

NENI I

Te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrtimin " "ATLLAS "SH.P.K. te ortakut te vetem Vladimir Basha.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete fshati Kordhoc, Gjirokaster.
Shoqeria mund te hapi filjale, perfaqesi dhe agjenci edhe ne vende te tjera te Republikes se Shqiperise me vendim te ortakut te vetem.

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete I5 vjete.
Ortaku i vetem i cili ka te gjitha kompetencat e asamblese se nje shoqerie sipas ligjit per shqoqerite tregetare mund te vendosi per zgjatjen e e afatit te veprimtarise se shoqerise ose per shperndarjene e saj ne cdo kohe dhe per cdo shkak sipas kushteve qe parashikon ligji per shoqerite tregetare?.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
- Prodhim i kartopecetave, leter higjenike, mbulese tavoline prej letre si dhe cdo lloj tjeter letre te perdorimit te perditeshem.
- Tregeti e pergjitheshme import-export e te gjitha mallrave te konsumit, ndertimit, elektro shtepiake etj.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte IOO.OOO leke dhe ndahet ne IOO pjese. Ky kapital eshte derdhur i teri nga ortaku i vetem Vladimir Basha ne Banken e Kursimeve, Gjirokaster.

NENI 6

Organi me i larte i shoqerise eshte ortaku i vetem i cili barazohet me asamblene e ortakeve lidhur me kompetencat ne shoqeri.
Kompetencat e ortakut te vetem qe barazohen me ato te asamblese percaktohen ne Statutin e shoqerise.

N E N I 7

Administratori i shoqerise caktohet Z. Vladimir Basha.Administratori perfaqeson shoqerine para cdo personi juridik dhe fizik.

N E N I 8

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqerise mbyllet me daten 3I Dhjetor te cdo viti.

N E N I 9

Shoqeria mbaron dhe veprimtaria e saj pushon me plotesimin e afatit s dhe para ketij afati me vendim te ortakut te vetem.
Me mbarimin e shoqerise ajo vihet ne likujdim.

N E N I IO

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin palet mund t'i drejtohen gjykates shqiptare ne pamundesi te zgjidhjes se tyre me pajtim.

ORTAKU THEMELUES
(VLADIMIR BASHA)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER

Nr. 8209 Rep.

V E R T E T I M

Ne Gjirokaster sot me daten I2.II.I997 para meje noteres Greta Kallojeri u paraqit personalisht i quajturi Vladimir Basha i biri i Aliqit i Dl. I969, banues ne Kordhoc, Gjirokaster i njojtur prej meje i cili deklaroi se nenshkrimi ne kete Akt themelimi eshte shprehje e lire e vullnetit te tij.

N O T E R E
(GRETA KALLOJERI)



## STATUTI
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR"ATLLAS"SH.P.K.

NENI I

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ATLLAS"SH.P.K. me ortak te vetem Vladimir Basha.

NENI 2

Shoqeria eshte person juridik privat qhqiptar dhe e ushtron veprimtarine ne perputhje me aktin e themelimit, te Statutit te shoqerise dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 3

Selia e shoqerise eshte fshati Kordhoc, Gjirokaster.
Shoqeria mund te hapi dhe dege te tjera, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 4

Kohezgjatja e veprimterise se shoqerise eshte I5 vjete.
Shoqeria ne cdo kohe dhe per cdo shkaku mund te shperndahet ose te shtyje afatin e veprimterise me vendim te asamblese se ortakeve.

NENI 5

Objekti dhe qellimi i veprimterise se shoqerise eshte:
-Prodhim i karto-pecetave, leterhigjenike ,mbulesa tavoline prej letre si dhe cdo lloj tjeter letre te perdoimit te perditeshem.
-Tregeti e pergjitheshme import-export e te gjitha mallrave te konsumit, ndertimit, elektro shtepiake etj.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte I00.000 leke dhe ndahet ne I00 pjese. Vlera e cdo pjese eshte I000 leke. Ky kapital eshte depozituar i teri nga ortaku i vetem Vladimir basha.

NENI 7

Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim te ortakut te vetem i cili ka te gjitha kompetencat e Asamblese se shoqerise sipas ligjit? Cdo ndryshim do te pasqyrohet ne librin e shoqerise ku shenohet kontributi per kapitalin e shoqerise.

NENI 8

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme .
Per transferimin tek ortaket e rinj qe mund te futen ne shoqeri, behet me miratim te ortakut te vetem qe ka kompetencat e asamblese se shoqerise sipas ligjit; ku percaktohet edhe personi tek i cili do te reélizohet ky kalim.

NENI 9

Ne rast shitjeje te pjeses se kapitalit ose te nnje pjese te tij tek nje person i trete akti i shitjes duhet bere me akt noterjal.

NENI IO

Per ortaket e shoqerise mbahet nje liber i vecante ne te cilen shenohe emrat e ortakeve; shtetesia e tyre si dhe adresa e selise ose e banimit te tyre, kontributi, pjeset me pjesemarrje te kapitalit dhe cdo ndryshm i personit ortak ne shoqeri.

Kundrejt shoqerise konsiderohen ortak dhe mund te ushtrojne te drejtat e tyre sipas ligjit vetem ata qe pasqyrohen dhe perfshihen ne librin e ortakeve.

NENI II

Organi me i larta i shoqerise eshte asambleja e ortakeve.
Ne kete shoqeri te gjitha kompetencat e asamblese qe ka sipas ligjit per shoqerite tregetare i ka ortaku i vetem.

NENI I2

Asambleja mblidhet jo me pak se dy here ne vit.Njoftimi per mbledhjen e asamblese behet me shkrim jo me pak se I5 dite para mbledhjes nga administratori

NENI I3

Asambleja e ortakeve zhvillon edhe mbledhje te Jashtezakonshme.
Ne keto raste mbledhja therritet me kerkesen e administratorit ose te ortakeve qe perfaqesojne I/IO pjese te kapitalit themeltar.

NENI I4

Shoqeria drejtohet nga nje ose me shume administratore qe zgjidhen nga asambleja e ortakeve.

Adminsitratori i shoqerise eshte caktuar Z. Vladimir Basha i biri i Maliqit i Dl. I969, banues ne Kordhoc, Gjirokaster.

NENI I5

Administratori i shoqerise kryen te gjitha veprimet e nevojshme ne interes te shoqerise. Ai perfaqeson shoqerine para cdo organi dhe peroni juridik ose fizik qofte privat ose publik.

NENI I6

Veprimtaria ekonomike -financiare e shoqerise mbyllet me daten 3I Dhjetor te cdo viti. Mbrenda tre muajve nga mbyllja e vitit ekonomik nxirret bilanci i shoqerise i cili analizohet nga ortaku i vetem, ose asambleja e shoqerise ne rast pranimi te ortakeve te tjere me vone

NENI I7

Fitimi i shoqerise ndahet ne raport me pjesemarrjen ne kapitalin themeltar ne shoqeri;

NENI 18

Ne rast shperndarjeje ose prishjeje te shoqerise caktohet Likujdatori; ose likujdatoret. Ata kryejne te gjitha veprimet per likujdimin e shoqerise sipas kerkeseve ligjore.

Shoqeria kur eshte ne likujdim respekton emertimin e saj ne te cilen shtohen fjalet "Ne likujdim"

NENI 19

Ne rast mosmarreveshjeje kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim do te zgjidhen ne rruge gjyqesore nga gjykatta shqiptare sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 20

Ky statut u perpilua ne tre kopje; nje kopje do te dorezohet ne Gjykaten e rrethit Tirane; nje ne zyrat e tatimeve dhe nje kopje do te mbaj ortaku i vetem.

ORTAKU THEMELUES
(VLADIMIR BASHA)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER

Nr. 8210 Rep.

VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 12.11.1997, une noterja Greta Kallojeri vertetoj nenshkrimin e te paraqiturit Vladimir Basha i biri i Meliqit i Dl. 1969, banues ne Kordhoc, Gjirokaster i cili deklaroi se ky nenshkrim eshte shprehje e lire e vullnetit te tij.




NOTERE
(GRETA KALLOJERI)